**VENDIM**
**Nr. 541, datë 19.9.2018**

# PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË DREJTËSISË PËR TË MITUR DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2018–2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur dhe të Planit të Veprimit 2018–2021, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, ministritë e linjës dhe institucionet e drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## STRATEGJIA E DREJTËSISË
PËR TË MITUR DHE PLANI I VEPRIMIT
2018–2021

**Akronime**

| | |
|---|---|
| ASHMDF | Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës |
| AS | Akademia e Sigurisë |
| DPA | Departamenti i Administratës Publike |
| DPB | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve |
| DPPSH | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit |
| DPSHP | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës |
| KLGJ | Këshilli i Lartë Gjyqësor |
| KLP | Këshilli i Lartë i Prokurorisë |
| KDIMDHP | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale |
| KKD | Komisioneri kundër Diskriminimit |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| KSHB | Komiteti Shqiptar i Birësimeve |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MB | Ministria e Brendshëm |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| MASR | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| RSH | Republika e Shqipërisë |
| SHM | Shkolla e Magjistraturës |
| PBA | Programi Buxhetor Afatmesëm |
| PP | Prokuroria e Përgjithshme |
| UP | Urdhri i Psikologut |

### Hyrje

Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të të miturve është një ndër prioritetet kyçe të Ministrisë së Drejtësisë, e jetësuar në Programin e Qeverisë Shqiptare nën objektivin madhor: "*Zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive procedurale*".

Ministria e Drejtësisë, mbështetur në kuadrin ligjor vendës dhe ndërkombëtar që rregullon fushën e të drejtave të fëmijëve vlerëson se interesi më i lartë i fëmijës është një parim i rëndësishëm, i cili duhet të gjejë zbatim së pari në të drejtën penale, por edhe atë administrative dhe civile. Ky vlerësim gjen konkretizim në

angazhimin për hartimin dhe finalizimin e një dokumenti të nevojshëm politikash për të miturit në konflikt me ligjin, të shoqëruar më një plan veprimi me prioritete, objektiva, masa dhe indikatorë gjithëpërfshirës, të matshëm dhe që kanë impakt të plotë në përmirësimin e të gjithë sistemit të drejtësisë që trajton çështjet e të miturve.

Mbrojtja e të drejtave të të miturve nëpërmjet garantimit të ofrimit të shërbimeve në sistemin gjyqësor ka qenë një nga rregullimet bazë të paketës më të fundit ligjore të normimit të sistemit të drejtësisë, në kuadër të reformës në drejtësi. Konkretisht, të miturit në sistemin e drejtësisë penale përbëjnë një kategori vulnerabël dhe garantimi i procedurave ligjore të shpejta, efektive dhe cilësore ka qenë synimi më i rëndësishëm i reformës në sistemin e drejtësisë penale, e konkretizuar kjo me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, si edhe një sërë normash të tjera materiale e procedurale.

Kjo paketë ligjore, lidhur me të drejtat e të miturve, ka pasur në fokus përmirësimin e mëtejshëm të përmbajtjes dhe formës në mënyrën e trajtimit të të miturve në sistemin gjyqësor, *si dhe trajtimin e specializuar që u ofrohet të miturve në komunitet*, duke ofruar mbështetje nga njëra anë subjektit të veprës penale që në këtë rast është i mitur dhe nga ana tjetër edhe viktimës dhe dëshmitarit të mitur. Ndër të tjera, fasha e mbrojtjes ligjore është zgjeruar, duke përfshirë në këto rregulla edhe të rinjtë deri në moshën 21 vjeç.

Për sa më sipër, si dhe në vazhdim të detyrimit institucional për garantimin e të drejtave të të miturve, prezantohet për herë të parë dokumenti politik "Strategjia e drejtësisë për të mitur", i shoqëruar me planin e veprimit për periudhën afatgjatë 2018–2021. Strategjia e Drejtësisë për të Mitur është hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020, Strategjinë Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017–2020, si *dhe Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020.* Miratimi i Dokumentit të Strategjisë dhe i Planit të Veprimit ka qenë një ndër masat e parashikuara në udhërrëfyesin e prioritetit nr. 5, "Të drejtat e njeriut", masa 4.8.1, "*Përfshirja e veprime në fushën e drejtësisë për të miturit në strategjitë dhe planet e veprimit që trajtojnë të drejtat e fëmijëve*", të miratuar me vendimin nr. 330, datë 28.5.2014, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e udhërrëfyesit për 5 prioritet e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013", si dhe në dokumentin e Planit të Masave Afatshkurtra të planifikuara për përmbushjen e 5 Prioriteteve të Komisionit Evropian për Shqipërinë, e përfshirë në prioritetin nr. 5, *"Të drejtat e njeriut"*, rekomandimi nr. 3, "*Legjislacioni mbi drejtësinë për të miturit duhet përshtatur me standardet ndërkombëtare. Shërbimet për viktimat e dhunës në familje duhen përmirësuar në kualitet, masë, mundësi aksesi dhe mbulim gjeografik*".

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018, të prezantuar më 17 prill 2018, theksohet se shprehimisht, se: *"Strategjia e Drejtësisë për të Miturit" që përfshin edhe drejtësinë për të miturit dhe aksesin e barabartë në drejtësi të fëmijëve është ende në pritje të miratimit".*

Për hartimin e këtij dokumenti është ngritur me urdhrin nr. 966, datë 3.2.2016, të ministrit të Drejtësisë, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë së drejtësisë për të miturit", grupi i punës i përbërë nga ekspertët të Ministrisë së Drejtësisë. Strategjia e drejtësisë për të miturit dhe plani i veprimit të saj janë hartuar nën ekspertizën profesionale të UNICEF-it dhe ka reflektuar gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në të gjitha dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

***Qëllimi i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit 2018–2021 është promovimi dhe mbrojtja më efektive e të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktima, dëshmitar të veprave penale, të miturit nën moshë për t'u ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore, kryesisht atyre penale, nëpërmjet implementimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve.*** Strategjia përmban një qasje ndërdisiplinore, që do të integrohet me të gjitha dokumentet e tjera ekzistuese kombëtare, e shoqëruar me aktivitete konkrete.

## KAPITULLI I
## ASPEKTET LIGJORE DHE KUSHTET AKTUALE

### I.1 ASPEKTET LIGJORE

*Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2016–2020,* në kuadër të synimit për qeverisje të mirë, garantimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, parashikon: "*Reformimin e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë dhe cilëson sistemin e drejtësisë për të miturit si një sfidë të rëndësishme".*

*Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017–2020* parashikon planin konkret me vizion: *"Shteti ligjor garantohet nga Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë, çka promovon konsolidimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm politik, ekonomik dhe social në vend".* Misioni i kësaj strategjie është: "*Zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikat më të mira evropiane".* Kjo strategji përcakton 8 objektiva:

- forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë;

- konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave;

- përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor, duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij, në përputhje me standardet evropiane;

- rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor penal dhe masave antikorrupsion përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale;

- përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë, duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar;

- shtimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin ndëshkimor;

- përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj vartëse;

- përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe vendosja e një kuadri ligjor për arbitrazhin.

Ndërkohë që *Strategjia e Drejtësisë për të Miturit* synon që të përfshijë në kuadër të këtyre objektivave të mëdhenj, objektivat për garantimin e parimeve themelore të drejtësisë për të mitur.

Në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e fëmijëve 2017–2020, të miratuar me VKM-në nr. 372, datë 26.4.2017, citohet se: "*Sistemi i drejtësisë në Shqipëri ende ka një përqasje ndëshkuese ndaj të miturve në konflikt me ligjin. Në një masë të madhe nuk arrin të marrë parasysh nevojat e tyre për mbrojtje, në respekt të të drejtave të tyre njerëzore dhe dinjitetit megjithëse ka pasur disa përmirësime gjatë viteve të fundit. Që në vitin 2009, me prezantimin e Shërbimit të Provës, jepen dënime alternative deri në 58% të rasteve të të miturve. Numri i fëmijëve që kanë kaluar nga paraburgimi gjatë viteve të mëparshme përgjithësisht ka qenë i paqëndrueshëm. Megjithatë, në vitin 2015 (208 raste) ka pasur një rënie të dukshme (rreth 40%) në krahasim me vitin 2014 (338 raste). Ditët e qëndrimit aty kanë pësuar rënie vetëm në vitin 2015 me një mesatare prej 125 ditësh (krahasuar me 140 në 2014) 40. Gjithashtu, jo rrallë procesi i drejtësisë për të miturit nuk është i përshtatshëm dhe miqësor për fëmijët. Janë bërë përpjekje për të ngritur kapacitetet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë, megjithatë kanë qenë sporadike. Gjithashtu, me qëllim promovimin e dhënies së dënimeve alternative për të miturit dhe riintegrimin e tyre në shoqëri, është e nevojshme të hartohen programe integrimi në komunitet, të forcohen më tej zyrat e shërbimit të provës përmes ngritjes/përmirësimit të kapaciteteve të punonjësve të shërbimit të provës. Realizimi i programeve integruese dhe riintegruese të qëndrueshme ka si qëllim uljen e nivelit të recidivizmit për fëmijët e përfshirë në sistemin e paraburgimit.*

Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, lind nevoja e përmirësimit të përmbajtjes dhe procedurave të administrimit të drejtësisë për fëmijë".

Progresraporti vjetor i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2014) ka evidentuar, për sa i përket drejtësisë për të mitur, mungesën e dhomave të veçanta për fëmijët nën 14 vjeç në rajonet e policisë dhe pengimin e aksesit të të miturve në sistemin e drejtësisë përmes tarifave gjyqësore.

Për sa i takon cilësisë së drejtësisë, Komisioni deklaron se sistemi audioincizues, i cili është element i rëndësishëm për drejtësinë e të miturve është instaluar në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, me përjashtim të Gjykatës Administrative të Gjirokastrës, por duhet punuar për përdorimin i tij efektiv. Problematikë tjetër e evidentuar është pamjaftueshmëria e alokimeve buxhetore për gjykatat mbi teknologjinë e informacionit (TI),[1] ndërkohë që ngritja dhe funksionimi i sistemeve *online* do të ndihmojë në adresimin e drejtësisë për të mitur.

Raportprogresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016 në kapitullin 23, "Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut" thekson se: "*Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përafruar legjislacionin ekzistues me standardet ndërkombëtare dhe për t'u tërhequr nga metoda ndëshkuese për të rinjtë që shkelin ligjin. Janë rishikuar një sërë ligjesh në kuadër të reformës në drejtësi, për të përafruar gjykimin e të rinjve në përputhje me standardet e Kombeve të Bashkuara. Po hartohen një kod i veçantë juridik për të rinjtë dhe një strategji për drejtësinë e fëmijëve. Në vitin 2015, 130 fëmijë më pak se sa në vitin 2014 janë dërguar në mjediset e paraburgimit dhe koha mesatare e mbajtjes në paraburgim është reduktuar. Gjithsesi, ende mungojnë planifikimi, buxhetimi dhe riedukimi i përshtatshëm i bazuar në komunitet dhe programet e riintegrimit të fëmijëve që shkelin ligjin. Disa kategori të fëmijëve, siç janë ato nga minoritetet etnike, fëmijët me aftësi të kufizuara, vajzat dhe fëmijët që jetojnë në zonat rurale, përballen me sfida në marrjen e mbrojtjes juridike*". Në vijim të raportit, Komisioni Evropian rekomandon "*... Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti: të përmirësojë mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e fëmijëve; ... të përmirësojë përpjekjet për të sjellë legjislacionin ekzistues për drejtësinë e të miturve në përputhje me standardet ndërkombëtare ...*".

Në raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018, të prezantuar më 17 prill 2018, theksohet se *(....) hapa të rëndësishëm janë bërë në drejtim të drejtësisë për të miturit (...) Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i marsit 2017, siguroi përputhshmërinë de jure me standardet ndërkombëtare të drejtësisë për të miturit në Shqipëri. "Strategjia e Drejtësisë për të Miturit" që përfshin edhe drejtësinë për të miturit dhe aksesin e barabartë në drejtësi të fëmijëve është ende në pritje të miratimit. Ligji i ri për ndihmën juridike të miratuar në dhjetor 2017 synon të sigurojë aksesin e fëmijëve në ndihmën ligjore. Në Ministrinë e Drejtësisë është ngritur një sektor për çështjet e drejtësisë penale për të miturit dhe do të zhvillojë një sistem online për gjurmimin e çështjeve me të mitur që kanë kryer vepra penale (...)*

Në kuadër të reformës në drejtësi është miratuar ligji nr. 37/2017, datë 30.3.2017, "Kodi i Drejtësisë Penale

[1] Përmbledhje e Raportit, f. 73.

për të Mitur" dhe ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve për trajtimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në datën 1 janar 2018 hyri në fuqi ligji nr. 37/2017, datë 30.3.2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", i cili përmban norma të posaçme ligjore lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo masë tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale, si dhe rregulla për të rinjtë nga grup-mosha 18 deri në 21 vjeç. Ky ligj përbën një risi dhe zhvillon standardet e legjislacionit shqiptar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në tërësi dhe të të miturve në konflikt me ligjin në veçanti. Kodi është një ligj i veçantë për shkak të përmbajtjes së tij, pasi përmbledh të gjitha dispozitat që referojnë të miturin në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, ligjin "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", si dhe ligje të tjera referuese të sistemit të drejtësisë penale për të mitur. Ky Kod siguron përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/93/BE datë 13.12.2011, përveç përputhjes me standardet ndërkombëtare dhe rajonale.[2] Në zbatim të plotë të këtij Kodi janë parashikuar një seri masash në Planin e Veprimit të saj, të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur.

Kështu, në sektorin e drejtësisë, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve trajtohet në 3 drejtime kryesore:

- përmirësimi i aksesit në drejtësi;
- informim dhe edukim ligjor; dhe
- parandalim, riintegrim dhe rehabilitim.

I.2 KUSHTET AKTUALE

I.2.1 Të miturit në konflikt me ligjin dhe ata viktima dhe dëshmitarë të veprave penale

Kushtet aktuale në trajtimin dhe sigurimin e të drejtave të fëmijëve fokusohet në dy grupe të margjinalizuara: i. të miturit në konflikt me ligjin; dhe ii. të miturit viktima dhe dëshmitarë të veprave penale.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë analizoi gjendjen aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë, me qëllim identifikimin e problemeve dhe nevojave për përmirësim. Dokumenti strategjik *"Strategjia e reformës në Sistemin e Drejtësisë"*, i hartuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë për objektivat në reformën e sistemit të drejtësisë, i cili parashikon në objektivin VIII, "*Reformimin e sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive të drejtave të tyre procedurale*"[3]. Ky dokument udhëheqës i reformës në drejtësi, jep orientimin për:

- miratimin e një Plani Strategjik për Drejtësinë për të Miturit, i cili të jetë në përputhje me rekomandimet dhe standardet evropiane;
- grupimin e dispozitave të posaçme për të miturit në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur; krijimin e strukturave të specializuara në institucionet e drejtësisë penale, të pajisura me kapacitetet, infrastrukturën, si dhe burimet e nevojshme (si financiare, ashtu edhe njerëzore) përgjegjëse për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin;
- si dhe zhvillimin e programeve të trajnimit për përfaqësuesit e institucioneve të sistemit të drejtësisë penale (prokurorë, gjyqtarë, punonjës të Shërbimit të Provës dhe administratës së burgjeve), në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin.

Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2017" citon se: "*hyrja në fuqi më 1 janar 2018 e ligjit nr. 37/2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", kërkojnë angazhim për rritjen e profesionalizmit të organeve kompetente në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur. Në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme. Aktualisht, kanë në strukturën e tyre psikolog, prokuroritë e shkallës së parë Tiranë e Durrës. Zbatimi me sukses dhe arritja e qëllimit të ndryshimeve ligjore, kërkojnë si angazhimin personal të çdo prokurori, angazhimin institucional, bashkëpunimin me aktorët e tjerë që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut ashtu edhe rritjen e kapaciteteve njerëzore në prokurori. Në muajin janar 2018, në Prokurorinë e Përgjithshme u ngrit një strukturë e posaçme për ndihmën ndaj subjekteve me status të posaçëm me përbërje prokurorë dhe ndihmës/ psikologë, megjithatë pers a u paraqit edhe më lart, është i nevojshëm shtimi i burimeve njerëzore në prokurori. Gjithashtu, vlerë të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të drejtat në kuadër të procesit penal, garantimin e një procesi që mbron interesin më të lartë të të miturit marrin trajnimet dhe tryezat e përbashkëta me gjithë aktorët e përfshirë në sistemin penal*".

Në raportin e Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2017" deklarohet se në lidhje me të pandehurit e mitur, nga të dhënat statistikore të vitit 2015 rezultojnë 978 të pandehur të mitur; në vitin 2016 rezultojnë 753 të pandehur të mitur të hetuar që përbën një ulje prej 23% krahasuar me një vit më

---

[2] Direktiva 2011/93 EU, datë 13.12.2011, Fletore Zyrtare nr. 335, datë 17.12.2011, si dhe standardet dhe rregullat për drejtësinë për të mitur në nivelin e OKB-së dhe Këshillit të Evropës.

[3] http://reformanedrejtesi.al/sites/default/files/draft_strategjia_versioni_shqip.pdf

parë dhe në vitin 2017 rezultojnë 510 të pandehur të mitur të hetuar që përbën një ulje prej 32,3% krahasuar me një vit më parë. Pra vërehet një ulje nga viti në vit i numri të të miturve të moshës 14 deri 18 vjeç të përfshirë në një hetim penal.

Të miturit dërguar gjyqit në vitin 2017 janë 386 ose 36,5% më pak se në vitin 2016, gjatë të cilit janë dërguar në gjykatë 608 të pandehur të mitur.

Në lidhje me të pandehurit e mitur të dënuar nga gjykata, nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2017 janë dënuar 393 të pandehur të mitur që përbën ulje prej 48,4 % në krahasim me vitin 2016 gjatë të cilit janë dënuar 762 të pandehur të mitur. Vjedhja e pasurisë përbën grup-veprat penale të kryera më së shumti nga të miturit 14 deri 18 vjeç, e konkretisht nga 44% e të pandehurve të mitur. Megjithatë në vitin 2017 numri i të miturve të hetuar për këto grup-vepra rezulton me ulje prej 24%. Një vepër tjetër penale problematike, për të cilën janë hetuar 21% e të pandehurve të mitur është ajo e "drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt". Lidhur me veprat penale kundër personit, rezulton se 15% e të miturve kanë kryer vepra penale drejtuar personit. Për veprat penale lidhur me narkotikët rezultojnë 9% e të pandehurve të mitur. Për veprat penale të parashikuara nga neni 278 i Kodit Penal, "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit" dhe neni 279 i Kodit Penal, "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta" janë hetuar 2% e të pandehurve të mitur. Pjesa tjetër e të miturve të regjistruar e hetuar kanë kryer vepra penale të tjera të cilat të veçuara nuk kanë peshë specifike të veçantë brenda totalit.

Lidhur me caktimin e dënimit për të pandehurit e mitur 14 deri 18 vjeç gjatë vitit 2017, rezulton se është kërkuar për 53% të të pandehurve të mitur caktimi i dënimeve alternative, kryesisht pezullimi i vendimit të dënimit me burg dhe vënia në prove, ndërsa në vitin 2016 është kërkuar caktimi i dënimeve alternative për 48,4% të të miturve të dënuar. Ndërsa, kërkesat e prokurorit për caktimin e dënimit me burg kanë ardhur duke u ulur çdo vit.

Situata e dy–tri viteve të fundit paraqet një përmirësim të dukshëm, krahasuar me periudhën e mëparshme.

"Vlerësimi i impaktit të reformave në fushën e drejtësisë për fëmijët në disa vende (2006–2012)", ndërmarrë nga UNICEF-i edhe në Shqipëri, veç 10 vendeve të tjera (draft 2015), evidentonte se ende Shqipëria mbetej vendi me përqindjen më të lartë të dhënies së dënimit me burg për fëmijët, siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




| | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Albania | 88.4% | 87.7% | 88.7% | 61.6% | 46.5% | 54.8% | 30.7% |
| Armenia | 13.7% | 17.3% | 21.3% | 9.6% | 12.5% | 14.5% | 17.9% |
| Azerbaijan | | 27.2% | 14.2% | 14.9% | 13.9% | 16.2% | 15.3% |
| Georgia | 13.5% | 20.7% | 17.5% | 11.3% | 15.7% | | 12.6% |
| Kazakhstan | 19.1% | 15.9% | 15.7% | 16.1% | 12.4% | 11.8% | 10.1% |
| Kyrgysztan | 9.4% | 11.1% | 9.2% | 11.9% | 11.3% | 8.2% | 9.6% |
| Moldova | 10.5% | 13.9% | 5.4% | 6.9% | 8.5% | 9.7% | |
| Montenegro | 6.3% | 7.4% | 2.6% | 2.8% | 4.0% | 2.6% | 5.1% |
| Tajikistan | 55.3% | 68.8% | 67.9% | 43.0% | 42.8% | 30.9% | 22.4% |
| Ukraine | 12% | 11% | 10% | 11% | 9% | 10% | 8% |

Po ashtu, ky vlerësim vinte në dukje përdorimin e shpeshtë të paraburgimit për të miturit në Shqipëri. Kështu, në të njëjtin vit krahasimi (2012), Shqipëria rezultonte me 186 të mitur në paraburgim, teksa vende si Mali i Zi, Armenia apo Azerbajxhani rezultonin me përkatësisht 2 fëmijë në paraburgim, 10 dhe 26. Shifrat e vitit 2016 të raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, paraqesin 191 fëmijë në paraburgim në vitin 2016, në Shqipëri, me një shkallë burgimi/paraburgimi prej 10.97[4] .

[4] Shkalla e burgimit/paraburgimit për fëmijët u llogarit në bazë të formulës së mëposhtme:

$$ShBF = \frac{\text{Numri i fëmijëve në burg/paraburgim në një periudhë të caktuar të vitit (tetor 2016)}}{\text{Numri i popullsisë së fëmijëve në Shqipëri, 2016}} x\ 100\ 000$$

Veç kësaj, edhe kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të fëmijëve në paraburgim në Shqipëri, krahasuar me të dhjetë vendet e tjera ku u zhvillua vlerësimi i sipërpërmendur paraqitej më e larta, si në tabelën më poshtë:

| Vendi | Viti 2012 |
|---|---|
| **Shqipëria** | 202 ditë |
| **Armenia** | 45 ditë |
| **Azerbajxhani** | 132 ditë |
| **Gjeorgjia** | 180 ditë |
| **Kazakistani** | 125 ditë |
| **Kosova**[5] | 56 ditë |
| **Kirgizstani** | 60 ditë |
| **Mali i Zi** | 15 ditë |
| **Moldavia** | 90 ditë |
| **Ukraina** | 30 ditë |

Edhe pse ky kohëqëndrim mesatar ka rënë në 92 ditë në vitin 2016, ka ende shumë për të bërë për të arritur së paku nivelin e vendeve fqinje, si Mali i Zi dhe Kosova. Për këto arsye, Strategjia ka parashikuar aktivitete për ndërgjegjësimin e përdorimit të masave alternative, si dhe masave të tjera të drejtësisë restauruese, me qëllim progresin e mëtejshëm.

Profesionistë të sektorit të drejtësisë kanë konkluduar se për 77% të të miturve, të cilët bien në kontakt me sistemin gjyqësor shkaqet lidhen me dhunën, abuzimin dhe neglizhencën në familje.[6] Rekomandime për marrjen e masave për trajtimin e viktimave të abuzimit seksual, viktimave të trafikimit dhe viktimave të mitura të dhunës në familje janë bërë edhe nga progresraportet e Komisionit Evropian.[7] Duke marrë parasysh këtë situatë, në muajin janar 2016, Prokuroria e Përgjithshme ka ngritur Zyrën e Ndihmës së Viktimave me objekt të punës sigurimin e informimit dhe këshillimit të viktimave të krimit me fokus të veçantë viktimat në moshë të mitur apo me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, viktimat e dhunës ose shfrytëzimit seksual, trafikimit të qenieve njerëzore dhe terrorizmit.[8]

Shqetësime të tjera të reflektuara në progresraportin e 2015 janë niveli i lartë i përsëritjes së shkeljeve nga të miturit, mungesa e mundësive për ofrimin e riedukimit dhe mungesa e koordinimit ndërmjet drejtësisë dhe sistemeve të mbrojtjes së të miturve që dalin nga sistemi i drejtësisë, të cilët kanë nevojë për mbështetje që të riintegrohen në shoqëri. Forcimi i Programit të Riintegrimit të miturve rekomandohet, gjithashtu, nga analiza e përgatitur në kuadër të Konventës për Integrimin Evropian, bazuar në të dhënën se 90% e të miturve kthehen në recidivistë.[9] Edhe në raportin "Për vlerësimin e kushteve dhe trajtimit në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit", përgatitur nga Avokati i Popullit më 2016-ën, deklarohet se aktualisht nuk ka shërbime rehabilitimi ose riintegrimi për fëmijët që kryejnë dënimet e tyre.[10] Mungojnë edhe shërbimet specifike për fëmijët që janë nën moshën e përgjegjësisë penale por që bien në kontakt me veprën penale. Duhet të ekzistojë një qasje më sociale dhe jo t'i jepet përparësi ndëshkimit por edukimit.[11]

Në zbatim të akteve ligjore të miratuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ku përmendim ligjin 37/2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", ka sjellë përparësi në mënyrën e trajtimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, për mbështetjen e fëmijëve viktimë apo të akuzuar në procesin penal, si dhe në trajtimin dhe mbrojtjen e të miturve, në lidhje me:

- garantimin e respektit dhe efektshmërinë në zbatimin e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet drejtësisë miqësore;
- aksesueshmërinë, përshtatjen e sistemit të drejtësisë në përputhje me nevojat dhe moshën e të miturve;

---

[5] Sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244.

[6] UNICEF "Children's Equitable Access to Justice: Central and Eastern Europe and Central Asia". E mundshme në: https://www.unicef.org/ceecis/Equitable_access_to_justice_for_children_in_Central_and_Eastern_Europe_and_Central_Asia_-_v2_1.pdf, aksesuar dhjetor 2016, f. 52.

[7] Progresraporti i KE-së të 2014-ës dhe ai i 2016-ës.

[8] Raport i Prokurorisë së Përgjithshme mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2015 i mundshëm në: https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/03/Raporti-PP-2015-FINAL.pdf aksesuar në dhjetor 2016.

[9] Konventa për Integrimin Evropian, Vlerësime dhe Rekomandime 2015–2016, "Lëvizja Evropiane në Shqipëri "Gjyqësori dhe të drejtat themelore", kapitulli 23, f. 27–29.

[10] Raporti "Me zërin e të miturve të privuar nga liria-vlerësimi i kushteve dhe trajtimit në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit". Avokati i Popullit dhe Observatori për të drejtat e fëmijëve, me mbështetjen e UNICEF-it, dhjetor 2016, f. 22.

[11] Konventa për Integrimin Evropian, Vlerësime dhe Rekomandime 2015–2016, "Lëvizja Evropiane në Shqipëri "Gjyqësori dhe të drejtat themelore", kapitulli 23, f. 27–29.

- pjesëmarrjen në proces gjyqësore, si dhe respektimin e jetës private dhe familjare;
- bashkëpunimin e vazhdueshëm të organeve të sistemit të drejtësisë që garantojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, jo vetëm në parandalimin e krimit por edhe në përcaktimin e masave restauruese të përshtatshme për të miturit në konflikt me ligjin, si dhe për rehabilitimin e tyre.

Kryesisht, veprat e kryera nga të miturit janë vjedhje, por vitet e fundit konstatohet përfshirja e të miturve në vepra penale të rënda, si plagosjet, vrasjet, tregtimi i lëndëve narkotike etj. Bazuar në këto të dhëna del si domosdoshmëri realizimi i analizave që trajtojnë fenomenet në mënyrë ndërdisiplinore, për të kuptuar cilat janë shkaqet dhe për të përcaktuar rrugët për përmirësimin e situatës.[12] Mungesa e një plani kombëtar për parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në krim është sjellë në vëmendje edhe nga Avokati i Popullit.[13]

Komiteti i Helsinkit në Shqipëri, në raportet e ti,j ka evidentuar mungesë psikologësh e punonjësish socialë të specializuar për të punuar posaçërisht me fëmijët e dënuar.[14] Psikologët janë me profil të përgjithshëm dhe intervistat e tyre nuk trajtojnë nevojat specifike të fëmijëve.[15]

I.2.2 Aksesi i barabartë i fëmijëve në drejtësi

Raporti vjetor i Progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2014) thekson se aksesi i fëmijëve në drejtësi pengohet nga tarifat gjyqësore. Aksesi në drejtësi referohet, gjithashtu, si problematikë në raportin e progresit të vitit 2015.

Në raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018, të prezantuar më 17 prill 2018, theksohet në mënyrë të posaçme çështja e aksesit të barabartë të fëmijëve në drejtësisë dhe miratimi i ligjit të ri i ndihmës juridike të miratuar që synon të sigurojë aksesin e fëmijëve në ndihmën ligjore.

Sipas raporteve të ndryshme të organizatave të tjera ndërkombëtare, po ashtu, një çështje e tillë është raportuar si një çështje e mbetur pezull që kërkon zgjidhje përfundimtare. Në klasifikimin global të shteteve nga Rrjeti Ndërkombëtar i të Drejtave të Fëmijëve (CRIN), Shqipëria renditet e 155-ta, duke u garantuar akses në drejtësi për vetëm 59.4% të fëmijëve.[16]

Raporti i UNICEF-it "Aksesi i Barabartë i Fëmijëve në Drejtësi: Evropa Qendrore, Lindore dhe Azia Qendrore", i cili fokusohej te Shqipëria, Mali i Zi, Gjeorgjia dhe Kirgistani, transmeton perceptimet e mëposhtme të profesionistëve të drejtësisë në lidhje me pengesat ndaj aksesit në drejtësi për fëmijët në situata vulnerabël.[17]

**TABELA NR.4:** Përgjigjet e dhëna nga profesionistët e sektorit të drejtësisë në lidhje me pengesat e aksesit në drejtësi për fëmijët në rrethana vulnerabiliteti

| Pengesa në kërkimin e drejtësisë | > Shqipëria | > Gjeorgjia | > Kirgizstani | > Mali i Zi |
|---|---|---|---|---|
| Nuk legjitimohet | 45% | 30% | 13% | 57% |
| Pengesa gjuhësore | 24% | 67% | 37% | 50% |
| Pengesa financiare | 93% | 63% | 47% | 43% |
| Largësia nga mekanizmat e mbështetjes institucionale | 69% | 43% | 30% | 30% |
| Mungesa e informacionit dhe mbështetjes | 83% | 67% | 57% | 67% |
| Mosbesimi ndaj institucioneve shtetërore | 52% | 33% | 33% | 40% |
| Kultura që e pranon dhunën në familje | 86% | 67% | 30% | 40% |
| Perceptimi i përgjithshëm për vendin që zë fëmija në familje | 72% | 40% | 20% | 47% |
| Frika nga përjashtimi social | 31% | 33% | 10% | 50% |
| Frika nga trajtimi diskriminues nga institucionet | 45% | 33% | 27% | 33% |

Ofrimi i ndihmës juridike falas është një element që nuk vlerësohet ende efektiv nga raportet

[12] Konventa për Integrimin Evropian, Vlerësime dhe rekomandime 2015–2016, "Lëvizja Evropiane në Shqipëri "Gjyqësori dhe të drejtat themelore", kapitulli 23, f. 27.

[13] Raporti "Me zërin e të miturve të privuar nga liria-vlerësimi i kushteve dhe trajtimit në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit", Avokati i Popullit, observatori për të drejtat e fëmijëve, me mbështetjen e UNICEF-it, dhjetor 2016, f. 22.

[14] Raport "*Mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në komisariatet e policisë së shtetit, në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në spitalet psikiatrike*", korrik 2015–janar 2016, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

[15] Konventa për Integrimin Evropian, Vlerësime dhe Rekomandime 2015–2016, "Lëvizja Evropiane në Shqipëri 'Gjyqësori dhe të drejtat themelore'", kapitulli 23, f. 27–29.

[16] E disponueshme në adresën: https://www.crin.org/en/access-justice-children-global-ranking, e aksesuar në dhjetor 2016.

[17] UNICEF-i, aksesi i barabartë i fëmijëve në drejtësi: Evropa Qendrore dhe Lindore dhe Azia Qendrore, e disponueshme në adresën: https://www.unicef.org/ceecis/Equitable_access_to_justice_for_children_in_Central_and_Eastern_Europe_and_Central_Asia_-_v2_1.pdf , December 2016.

ndërkombëtare.[18] Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike, pohon raporti, nuk ka zhvilluar ende mekanizma efektivë për shtrirje dhe qasje në shërbimet e tij, duke përfshirë edhe në nivel rajonal, gjë që reflektohet edhe në përqindjen e fëmijëve që kanë vështirësi për të aksesuar drejtësinë. Mekanizmi i veçantë për ankesa ende mungon, megjithëse ligji për ndihmë juridike përmban dispozita në lidhje me të. Megjithatë, po punohet për reformimin e sistemit të ndihmës juridike.

Në Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë është evidentuar problematika të sistemit shqiptar për sa i takon drejtësisë për të mitur, duke cituar afatin e paarsyeshëm të mbajtjes në ambientet e strukturës së policisë të fëmijëve, ambientet e papërshtatshme, mungesën e psikologëve, domosdoshmërinë për trajnimin e profesionistëve të sistemit të drejtësisë që punojnë me të miturit. Për më tepër është vënë re mungesa e qasjeve multidisiplinore (bashkëpunimi mes shërbimit social, arsimor, policisë së shtetit, shërbimit të provës, prokurorisë etj.). Barrierat financiare janë parë, gjithashtu, si penguese për aksesin e fëmijëve, prindërve/kujdestarëve të tyre për adresimin e problemeve që lidhen me shkeljen e të drejtave të fëmijëve, këto të sferës penale, civile, familjare, administrative.

## KAPITULLI II
## VIZIONI, PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

### II.1 VIZIONI

Vizioni i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit është "*Përmirësimi i drejtësisë për të mitur që garanton një drejtësi miqësore për fëmijë dhe që mbron interesin më të lartë të tyre*".

Ky vizion është në të njëjtën linjë me vizionin mbi sektorin e drejtësisë të deklaruar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020, se: "*Shqipëria: një vend i bazuar te shteti ligjor, garantuese e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, me një sistem drejtësie të hapur dhe të barabartë që garanton drejtësi për të gjithë*" dhe me vizionin e deklaruar nga Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017–2020, se: "*Forcimi i shtetit ligjor është një kusht themelor për konsolidimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm politik, ekonomik dhe social në vend. Suksesi i reformave të drejtësisë varet në shkallë të madhe nga ndërveprimi mes institucioneve të pavarura gjyqësore dhe bashkëpunimi i ngushtë me palët e interesuara dhe shoqërinë civile*".

### II.2 Prioritetet

Prioritetet në realizimin e vizionit strategjik fokusohen në qasjen te një *drejtësi miqësore për të mitur*, e cila u referohet sistemeve të drejtësisë të cilat garantojnë respektimin dhe implementimin efektiv të të drejtave të fëmijëve, duke pasur parasysh parimet e mëposhtme dhe duke mbajtur në konsideratë nivelin e pjekurisë së fëmijës dhe rrethanat e çështjes. E ndarë në komponentë nënkupton drejtësi të aksesueshme, të përshtatshme me moshën, të shpejtë, efektive, të përshtatur dhe të fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijëve, ku përfshihet e drejta për proces të rregullt, e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për të kuptuar procedurat, si dhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, integritetit dhe dinjitetit të fëmijës.

### II.3 Objektivat strategjikë

Strategjia e Drejtësisë për të Miturit evidenton domosdoshmërinë për përmirësim në fushat e mëposhtme:
- përmirësime legjislative të normave që rregullojnë sektorin e drejtësisë për të mitur;
- përmirësime infrastrukturore të institucioneve mbështetëse të drejtësisë për të mitur;
- rritje të kapaciteteve të profesionistëve që merren me të miturit.

Këto sfida, strategjia i adreson në mënyrë pragmatike dhe pozitive me objektivat strategjikë, konkretë, si më poshtë:

**Objektivi strategjik 1. Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi**

Strategjia parashikon se aksesi në drejtësi do të garantohet duke dhënë rezultate konkrete të matshme me: i. numrin e e strukturave dhe i profesionistëve që ofrojnë ndihmë juridike; ii. numrin e mjediseve të rikonstruktuara në përshtatje me nevojat e të miturve; dhe iii. numrin e aktiviteteve sensiblizuese për drejtësinë për të miturit. Ky aspekt lidhet me kapacitetin e të miturve për t'i aksesuar shërbimet e drejtësisë për të miturit dhe përfshin ndërgjegjësimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas, si aktivitet konkrete të të cilave do të konkretizohen në kapitullin vijues.

**Objektivi strategjik 2. Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit**

Duke mbajtur në konsideratë detyrimin e vendit për të respektuar dhe për të garantuar të drejtat e parashikuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, strategjia ka parashikuar aktivitete konkrete me qëllim garantimin e kësaj të drejte për të miturit e përfshirë në procese gjyqësore. Në fokus të strategjisë është garantimi i gjykimit brenda një kohe të arsyeshme, përmirësimi i kuadrit ligjor që normon të drejtat e fëmijëve dhe mbështetja e të miturit në çdo proces nga profesionistë të trajnuar dhe të specializuar. Strategjia parashikon se ky objektiv do të garantohet duke dhënë rezultate konkrete, në lidhje me: i. numrin e seksioneve

[18] Raporti i progresit i BE-së për vitin 2016.

të specializuara për të miturit në gjykata dhe prokurori; ii. numrin e profesionistëve të trajnuar për çështjet e drejtësisë për të miturit; iii. numrin e institucioneve që hedhin të dhëna në Sistemin e Integruara të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit; dhe iv. numrin e akteve ligjore/nënligjore të miratuara në fushën e drejtësisë për të miturit.

**Objektivi strategjik 3. Parandalimi i ripërfshirjes në krime të të miturve/të rinjve në krime**

Mënyra më e mirë për reduktimin e numrit të të miturve në konflikt me ligjin është parandalimi.[19] Ky sugjerim vjen edhe nga Komenti i Përgjithshëm nr. 10 i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës.[20]

Për realizimin e këtij objektivi planifikohet të analizohen faktorët e riskut dhe masat mbrojtëse. Duke pasur parasysh se kjo është strategjia e parë për drejtësinë për të mitur, objektivi fokusohet në mënyrë të veçantë te ngritja dhe vënia në funksionim e Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, si dhe te programet për parandalimin e ripërfshirjes së të miturve në vepra penale (recidivizmit), të cilat do të kenë në qendër të vëmendjes mbështetjen për fëmijët dhe familjet, veçanërisht, fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale dhe grupeve në risk apo të cenueshme (vulnerabël). Parandalimi i krimit është zgjidhja më e mirë për fëmijët, familjet e tyre, komunitetet dhe shoqërinë në tërësi.

**Objektivi strategjik 4. Rishoqërizimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin**

Strategjia synon riintegrimin dhe përfshirjen sociale të të miturve autorë të veprave penale dhe përfshirjen efektive të tyre në komunitet. Ky proces nuk lidhet domosdoshmërisht me kohën pas dënimit penal, por duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës që në momentet e para kur fëmija gjendet në konflikt me ligjin. Për realizimin e këtij objektivi strategjik është i domosdoshëm dhe parashikohet ndërveprim dhe bashkëpunim proaktiv mes institucioneve të ndryshme shtetërore, veçanërisht, të atyre që kanë fushë të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; bashkëpunim dhe koordinim midis organeve të sistemit të drejtësisë dhe institucioneve shtetërore: Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit të Provës, Policisë, Prokurorisë, organeve të vetëqeverisjes vendore dhe njësive për mbrojtjen e fëmijës, Shërbimit Social, institucioneve të arsimit, shëndetësisë dhe aktorëve të tjerë me ndikim në komunitet.

Një ndër masat e parashikuara nga legjislacioni vendës janë masat edukuese, për ekzekutimin e të cilave strategjia parashikon ngritjen e institucioneve për ofrimin e këtij shërbimi, ndërsa për të miturit e dënuar planifikohet ngritja e qendrave të veçanta (vetëm për të mitur).

Qëllimi i këtij objektivi është rehabilitimi i të miturve, inkurajimi dhe zhvillimi, në kuptim të përgjegjësisë së të miturit, e ndjenjës së respektimit të të drejtave të të tjerëve, nxitja dhe mundësimi i zhvillimit të shëndoshë fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror i të miturit dhe për ta përgatitur atë që të rikthehet në shoqëri.

Strategjia parashikon që realizimin e këtij objektivi ta masë nëpërmjet: i. numrit të fëmijëve dhe të familjeve të përfshira në programet e riintegrimit; ii. numrit të fëmijëve të dënuar me burgim dhe me masa alternative dhe numrin e fëmijëve ndaj të cilëve janë zbatuar masat alternative të shmangies nga ndjekja penale.

**Objektivi strategjik 5. Forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë për të miturit**

Vlerësohet se kusht thelbësor për implementimin në mënyrën e duhur dhe efektive të të drejtave dhe garancive të fëmijëve është bashkëpunimi, ndërveprimi dhe bashkërendim i institucioneve dhe i autoriteteve në nivel qendror dhe vendor të përfshira në administrimin e drejtësisë për të mitur. Rrjedhimisht, strategjia parashikon ngritjen dhe funksionimin e rrjetit ndërinstitucional në nivel qendror dhe funksionimin e komunitetit të praktikantëve në nivel vendor.

## KAPITULLI III
## POLITIKAT

Objektivat strategjikë do të adresohen nëpërmjet politikave të mirëmenduara dhe të programuara me qëllim dhënien e impaktit pozitiv dhe qëndrueshëm në respektimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në marrëdhënie me organet e sistemit të drejtësisë, të konkretizuara si më poshtë:

**Objektivi strategjik 1: Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi**

Ky objektiv strategjik do të arrihet përmes zbatimit të objektivave specifikë të mëposhtëm:

1.1 Ofrimi i ndihmës juridike për përfituesit e mitur që ky shërbim të jetë i shpejtë, profesional dhe efektiv;

1.2 Krijimi i kushteve infrastrukturore të përshtatshme me nevojat e të miturve;

1.3 Organizimin e fushatave sensibilizuese për aksesin e të miturve në drejtësi dhe të shërbimeve që ofron

---

[19] Penal Reform International, *Protecting children's rights in criminal justice systems*, Chapter 2, e mundshme në: https://www.penalreform.org/wp-content/uploads/2013/11/Childrens-rights-training-manual-Final%C2%ADHR.pdf, aksesuar në dhjetor 2016.

[20] The Committee on the Rights of the Child's General Comment No. 10, gjendet në: http://www.2.ohchr.org/english/bodies/crc/docs/CRC.C.GC.10.pdf, aksesuar në dhjetor 2016.

sistemi për ta.

Në vitin 2020 pritet të kemi një skemë të re të ofrimit të ndihmës nga shteti, rritje të % së përdorimit dhe cilësisë së ndihmës juridike falas nga të miturit, numër të mjaftueshëm avokatëve, kryesisht të specializuar/të trajnuar për të miturit në konflikt me ligjin, infrastrukturë të përshtatur që mundëson aksesueshmërinë fizike të ambienteve të policisë, prokurorisë dhe gjykatave nga të miturit me aftësi të kufizuara, si dhe informacion dhe aktivitete sensiblizuese për fëmijët, në lidhje me proceset ligjore në të cilat përfshihen.

**Objektivi strategjik 2. Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit**

Ky objektiv strategjik do të arrihet përmes zbatimit të objektivave specifikë të mëposhtëm:

2.1 Seksione të specializuara për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të miturit;

2.2 Profesionistë të specializuar në drejtësinë për të miturit;

2.3 Shqyrtimi i drejtë dhe në kohë i çështjeve të drejtësisë për të miturit;

2.4 Përmirësimi i kuadrit ligjor të drejtësisë civile, penale dhe administratave që normon të drejtat e të miturve në sistemin e drejtësisë.

Deri në vitin 2020 pritet të kemi seksione të specializuara për të miturit në gjykata dhe prokurori, profesionistë të trajnuar dhe të specializuar, harmonizim të legjislacionit për mbrojtje më të mirë të të drejtave të fëmijës.

Deri në vitin 2021 pritet të jenë zhvilluar trajnime sistematike dhe të jetë konsoliduar rrjeti i profesionistëve që merren me fëmijët në konflikt/ kontakt me ligjin.

Gjithashtu, planifikohet të merren masa për krijimin dhe funksionimin e bazave të të dhënave të çështjeve gjyqësore që përfshijnë të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktima dhe dëshmitarë të veprave penale dhe bërjen e të dhënave të aksesueshme.

Në vitin 2018 është planifikuar plotësimi i kuadrit nënligjor të drejtësisë penale për të mitur në zbatim të ligjit nr. 37/2017, datë 30.3.2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur".

**Objektivi strategjik 3. Parandalimi i ripërfshirjes së të miturve/të rinjve në krime**

Ky objektiv strategjik do të arrihet përmes objektivit specifik për parandalimin e kriminalitetit dhe shkelje të ligjit, duke e konkretizuar me aktivitete që lidhet me krijimin e Qendrës për Parandalimin e Kriminalitetit të Fëmijëve dhe të Rinjve pranë Ministrisë së Drejtësisë, vlerësimin e kriminaliteti për të miturit nën 14 vjeç, identifikimin e grupeve në risk, si dhe sigurimin e kuadrit infrastrukturor për zbatimin e programeve të parandalimit.

Në vitin 2019 pritet të funksionojë Qendra për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve pranë Ministrisë së Drejtësisë, do të hartohen memorandume bashkëpunimi në nivel lokal, me qëllim parandalimin e përfshirjes në krime të të miturve, si dhe të hartohet Programi i Rehabilitimit për Fëmijët nën 14 vjeç dhe të ketë filluar implementimi. Pritet që në vitin 2019 numri i të miturve recidivistë të jetë ulur me 40%.

**Objektiv strategjik 4. Rishoqërizimi, riintegrim dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt ose në konflikt me ligjin**

Ky objektiv strategjik do të arrihet përmes zbatimit të objektivave specifikë të mëposhtëm:

4.1 Aplikimi i programeve të drejtësisë restauruese/të ndërmjetësimit;

4.2 Zhvillimi i planeve të këshillimit për të miturit dhe/ose familjen e tij;

4.3 Nxitja e aplikimit të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale;

4.4 Inkurajimi i aplikimit të masave alternative nga dënimi;

4.5 Garantimi i një kuadri institucional që nxit dhe lehtëson edukimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve në institucionet e paraburgimit dhe të burgimit

Pritet që deri në vitin 2019 të jetë rritur numri i masave alternative të dhëna për të miturit dhe të aplikimit të drejtësisë restauruese.

Në vitin 2021 do të jenë ngritur programe/ qendra të edukimit dhe riintegrimit për fëmijët në konflikt me ligjin. Për prindërit e të miturve autorë, të miturve nën moshë për t'u ndjekur penalisht dhe viktima të veprave të paligjshme, do të jenë vënë në zbatim programet e këshillimit dhe të rehabilitimit.

**Objektivi strategjik 5. Rritje e kapaciteteve të strukturave të sistemit të drejtësisë për të mitur**

Ky objektiv strategjik do të arrihet përmes zbatimit të objektivit specifik të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional që përfshin krijimin e rrjetit ndërinstitucional me përfaqësues në nivel teknik nën drejtimin e MD-së dhe mbledhjen e drejtuesve të institucioneve në nivel vendor që trajtojnë çështjet e të miturve.

Një rrjet ndërsektorial do të jetë ngritur në nivel të qeverisjes qendrore, i cili do të kontribuojë në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës së institucioneve në nivel qendror, si dhe për të nxitur vënien në zbatim dhe mbikëqyrur mbarëvajtjen e këtij bashkëpunimi edhe në nivel vendor.

KAPITULLI IV
BURIMET FINANCIARE, HENDEKU FINANCIAR DHE MENAXHIMI I RISKUT

Në këtë kapitull trajtohen në mënyrë të përmbledhur analiza që lidhen me nevojat për përdorimin e burimeve financiare, të nevojshme për zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur. Qëllimi i kësaj analize është të paraqesë kostot e Planit të Veprimit 2018–2021, si dhe burimet financiare të alokuara nga buxheti i shtetit, donatorë dhe burime të tjera për zbatimin e tij.

## IV.1 Metodologjia e kostimit të aktiviteteve të planit të veprimit

